



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT

TË

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

2024-2028

*Në Mbështetje të Objektivave Specifike të Strategjisë për Arsimin në Shqipëri
Ekselencë në Mësimdhënie, Kërkim Shkencor dhe Inovacion – Ndërkombëtarizimi dhe
Integrimi në EHEA – Njohuri dhe Zhvillim të Qëndrueshëm – Përparimi i Shërbimeve
Digjitale – Nivel të Avancuar për Mësimdhënien dhe Mësimnxënien*



HYRJE

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është institucion publik i arsimit të lartë me traditë të përvojë të gjerë në mësimdhënie në kërkimin shkencor. Bazuar në profilin dhe synimet e tij, universiteti "Aleksandër Xhuvani" ka hartuar "Strategjinë e Mësimdhënies, Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Ndërkombëtarizimit, Njohurive dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Përparimit të Shërbimeve Digjitale dhe Nivelit të Avancuar për Mësimdhënie dhe Mësimnxënie".



Kjo strategji është në përputhje:

- me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (Neni 6/20), dhe paraqet prioritetet strategjike për periudhën kohore 2024-2028.
- me *Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit të Lartë në Shqipëri*, si dhe me objektivat më të gjera të përcaktuara nga *Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë* (EHEA) dhe *Procesi i Bolonjës*.

Qëllimi i kësaj strategjie është përmirësimi i cilësisë akademike dhe qëndrueshmërisë institucionale, duke krijuar një mjedis dinamik mësimor i cili është në koherencë me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë. Ajo e pozicionon Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" si lider në kontekstin e Arsimit të Lartë Shqiptar, të njohur për kontributet e tij në dije, kërkim shkencor dhe inovacion."

Strategjia pasqyron vizionin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për politikat afatmesme dhe afatgjata në zhvillimin akademik, qëndrueshmërinë institucionale, inovacionin, ekselencën në kërkimin shkencor dhe ndërkombëtarizimin. Hartimi i saj është bërë duke pasur parasysh Standardet Kombëtare dhe Evropiane të Arsimit të Lartë. Procesi i transformimit të cilësisë së një sistemi kompleks, siç është mësimdhënia dhe zotërimi i dijes apo i kompetencave, kërkon kohë. Prandaj, për këtë arsye, strategjia e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ka shtrirje kohore për një periudhë katërvjeçare për të garantuar ndryshime efektive dhe të qëndrueshme.

Ky dokument pasqyron kontributet e përbashkëta të stafit akademik, personelit administrativ dhe studentëve të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Ai është hartuar me kujdes duke marrë parasysh vlerat dhe parimet themeloretë institucionit, siç janë cilësia akademike, integriteti, gjithëpërfshirja dhe qëndrueshmëria.

Strategjia udhëhiqet nga një qasje e orientuar drejt studentëve, duke krijuar një mjedis që mbështet rritjen personale dhe profesionale. Ajo thekson rëndësinë e ofrimit të mësimdhënies cilësore, udhëheqjes etike dhe angazhimit të komunitetit si shtylla themelore të misionit të universitetit.

Duke u mbështetur në modelin akademik të suksesshëm të Universitetit dhe përvojat e vlefshme të nismave strategjike të mëparshme, ky plan paraqet nevojën për përmirësime të vazhdueshme në qeverisje, nëmenaxhim dhe në sigurimin e cilësisë. Si strategji zhvillimi, ajo kërkon modernizimin e infrastrukturës, teknologjisë, stafit akademik dhe atij administrativ, me qëllim që Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të konkurrojë denjësisht përkrah universiteteve të tjera dhe të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Arsimit të Lartë.

Ky dokument shërben si një plan veprimi për rritjen e qëndrueshme institucionale duke theksuar inovacionin, kërkimin dhe të nxënit gjatë gjithë jetës, si boshtet themelore të drejtimeve të punës së universitetit. Ato promovojnë bashkëpunimin si një perspektivë ndërkombëtare për zhvillimin e niveleve të avancuara dhe për të përmbushur kërkesat në zhvillim të Arsimit të Lartë dhe shoqërisë në tërësi.



BAZA LIGJORE E INSTITUCIONIT



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" e ka origjinën e tij në vitin 1909 me hapjen e Shkollës Normale të Elbasanit, institucioni i parë kombëtar shqiptar i dedikuar për formimin e mësuesve. Gjatë viteve, e zgjeroi fushën e tij akademike, duke u transformuar në një universitet të mirëfilltë. Ai e fitoi statusin aktual në vitin 1991 me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 12.11.1991.

Prejkatër dekadash, luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e mësuesve, specialistëve, studiuesve dhe shkencëtarëve në një gamë të gjerë fushash akademike. Fokusi i tij ka qenë krijimi e brezave të profesionistëve, angazhimi për zhvillimin e tyre profesional, intelektuale kulturorë cilëtkanë dhënë kontribut në sektorë të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuarnë Urdhrin nr. 49, datë 27.11.2020, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" u akreditua institucionalisht nga Bordi i Akreditimit i Agjencisë Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, të Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve, për një periudhë maksimale prej gjashtë vitesh, nga 27.11.2020 deri më 26.11.2026.

Një numër i konsiderueshëm programesh Bachelor dhe Master (si Master Shkencor, ashtu edhe Master Profesional) janë akredituar në përputhje me Procesin e Bolonjës, ndërsa programe të tjera të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë janë akoma në proces akreditimi.

Qëllimi institucional është përfundimi i akreditimit të të gjitha programeve që ofrohen, duke rritur më tej standardet akademike të Universitetit.

Veprimtaria e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" rregullohet nga një sërë dokumentesh themelore, ndër të cilat më kryesori është Statuti i rishikuar, i miratuar në vitin 2018, me Vendimin nr. 144 të Senatit Akademik, datë 26.03.2018.

Ky Statut, i hartuar përputhje me ligjin aktual për Arsimin e Lartë, është miratuar nga Ministria e Arsimit e Sporteve dhe e Rinisë me Dekretin nr. 366, datë 05.07.2018.

Statuti rregullon veprimtarinë akademike dhe administrative të universitetit në bashkërendim me rregulloret e tjera të brendshme, siç janë Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Programeve të Studimit, Urdhrat dhe aktet e tjera, duke siguruar transparencë dhe përgjegjëshmëri në aktivitetet e tij. Të gjitha këto akte të brendshme pasqyrojnë vizionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, të përvijuara me filozofinë e tij të thellë.

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" e ndërton punën e tij bazuarnë strategji afatgjata dhe afatshkurtra të mirëstrukturuara, me objektiva të përcaktuara qartë dhe të arritshme. Misioni kryesor i tij është t'u ofrojë studentëve njohuri të thelluara, të përshtatshme me kërkesat e tregut të punës dhe të kultivojë interesin e tyre të vazhdueshëm për studime e zhvillime mëtejshme shkencor.



ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I PROGRAMEVE TË CIKLEVE TË STUDIMIT DHE STRUKTURËS ORGANIZATIVE NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", me pesë fakultetet e tij, synon cilësinë në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe inovacionin, dhe duke aspiruar ndërkombëtarizimin dhe integrimin në *Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë* (EHEA).

Plani i tij strategjik thekson zhvillimin e qëndrueshëm të dijes, përmirësimin e shërbimeve digjitale dhe ofrimin e metodave bashkëkohore për mësimdhënien dhe të nxënit. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit në Shqipëri, Universiteti synon të tërheqë studentë ndërkombëtarë dhe të forcojë partneritetet vendase e ato huaja. Krijimi i një mjedisi akademik multidisiplinar e gjithëpërfshirës, i cili përgatit studentët të përballojnë në mënyrë të suksesshme kërkesat bashkëkohore të tregut të punës është objektiv i synuar.

Universiteti ofron programe studimi në tri ciklet akademike:

- Cikli i Parë - Bachelor;
- Cikli i Dytë- Master Shkencor dhe Master Profesional;
- Cikli i tretë- Studime Doktorate;
- Diploma me karakter profesional.

Këto programe ofrohen në disa fakultete, ku secili është i specializuar në një fushë të caktuar studimi.

1. Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë

Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë ofron programe në nivelet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë.

1.1. Cikli i Parë "Bachelor":

- Bachelor në "Administrim Biznesi" përfshin;
- Bachelor në "Financë dhe Kontabilitet";
- Bachelor në "Ekonomia dhe e Drejta";
- Bachelor në "Administrim Biznesi dhe Inxhinieri";
- Bachelor në "Ekonomi Turizëmi";
- Bachelor në "Informatikë Ekonomike".

1.2. Programet e Ciklit të Dytë "Master Profesional" dhe "Master Shkencor" në këtë fakultet përfshijnë:

- Master Profesional në "Administrim Biznesi";
- Master Profesional në "Financë";
- Master Profesional në "Kontabilitet";
- Master Profesional në "Ekonomia dhe e Drejta në Sektorin Publik
- Master Profesional në "Informatikë Ekonomike";

- Master Profesional në “Marketing”;
- Master Shkencor në “Menaxhim”;
- Master Shkencor në “Drejtimit Bankar”;
- Master Shkencor në “Kontabilitet dhe Auditim”;
- Master Shkencor në “Ekonomi dhe e Drejta në Tregjet Ndërkombëtare”;
- Master Shkencor në “Marketing”.



1.3. Programet e Ciklit të Dytë “Diplomë e Integruar në Master Shkencor të Ciklit të Dytë” në këtë fakultet janë:

- Program i Integruar i Ciklit të dytë Master Shkencave në “Drejtësi”.

1.4. Programet e Ciklit të Tretë “Doktoratë në Shkencat e Biznesit dhe të Drejtësisë” në këtë fakultet janë në proces.

Struktura e Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë

Departamentet:

- Departamenti i Administrim Biznesit;
- Departamenti i Financës dhe i Kontabilitetit;
- Departamenti i së Drejtës;
- Departamenti i Ekonomiksit;
- Departamenti i Marketingut dhe i Inxhinierisë;
- Qendra e Kërkimit Shkencor për Kërkimin dhe Zhvillimin në Drejtësi dhe në Ekonomi.

2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron programe në ciklin e parë dhe të dytë, si dhe diploma me karakter profesional.

2.1. Cikli i Parë "Bachelor"përfshin:

- Bachelor në “Biologji - Kimi”;
- Bachelor në “Studime Mjedisore”;
- Bachelor në “Matematikë - Fizikë”;
- Bachelor në “Matematikë dhe Informatikë”;
- Bachelor në “Fizikë Kompjuterike”;
- Bachelor në “Teknologji Informacioni”;

2.2. Programet e Ciklit të Dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në këtë fakultet përfshijnë:

- Master Profesional në “Analist Prodhimi”;
- Master Profesional në “Teknologjitë e Informacionit”;
- Master i Shkencave në “Mbrojtje e Mjedisit”;
- Master i Shkencave në “Matematika e zbatuar”.

2.3. Programet “Diplomë me karakter Profesional” në këtë fakultet përfshijnë:

- Program me karakter Profesional në “Teknik Mjedisit”;
- Program me karakter Profesional në “Logjistikë”;
- Program me karakter Profesional në “Mekatronikë”;
- Program me karakter Profesional në “Teknologji Laboratori”.

Struktura e Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Departamentet:

- Departamenti i Biologjisë;
- Departamenti i Matematikës;
- Departamenti i Fizikës;
- Departamenti i Kimisë;
- Departamenti i Informatikës;
- Laboratori Eksperimental.



3. Fakulteti i Shkencave Humane

Fakulteti i Shkencave Humane ofron programe në nivelet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, si dhe diploma që kanë karakter profesional.

3.1. Cikli i Parë "Bachelor" përfshin:

- Bachelor në "Gjuhë shqipe dhe Letërsi";
- Bachelor në "Histori - Gjeografi";
- Bachelor në "Gjuhë Angleze";
- Bachelor në "Gazetari".

3.2. Programet e Ciklit të Dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" në këtë fakultet përfshijnë:

- Master i Shkencave në "Gjuhësi;
- Master i Shkencave në "Studime Historike";
- Master i Shkencave në "Trashëgimi Kulturore".

3.3. Programet e Ciklit të Tretë "Doktoratë" në këtë fakultet përfshijnë:

- Doktoratë në "Albanologji, nënfusha Gjuhësi dhe nënfusha Histori".

3.4. Programet "Diplomë me karakter Profesional" në këtë fakultet përfshijnë:

- Program me karakter Profesional në "Sekretar i Specializuar dhe Administrativ";
- Program me karakter Profesional në "Operator Turistik në Gjuhën Gjermane";
- Program me karakter Profesional në "Operator Turistik".

Struktura e Fakulteti i Shkencave Humane

Departamentet:

- Departamenti i Gjuhësisë ;
- Departamenti i Letërsisë dhe i Gazetarisë;
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
- Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë;
- Qendra për Studime Albanologjike dhe Ballkanike.

4. Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Fakulteti i Shkencave të Edukimit ofron programe në ciklet e parë dhe të dytë, si dhe diploma me karakter profesional.

4.1. Cikli i Parë "Bachelor" përfshin:

- Bachelor në "Filozofi-Sociologji";
- Bachelor në "Punonjës Social";
- Bachelor në "Psikologji";
- Bachelor në "Edukimin Fizik dhe Sporte";
- Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor, Klasa I-VI";
- Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor";

4.2. Cikli i Dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" në këtë fakultet përfshin:

- Master Profesional në "Punonjës Social me Fëmijët dhe Familjet";
- Master Profesional në "Shërbim Prove";
- Master Profesional në "Psikolog në Institucione";
- Master profesional në "Mësuesi për arsimin fillor";
- Master Profesional në "Mësues në Arsimin e Mesëm të Ulët për Gjuhën e Huaj Italiane me profil minor në Gjuhën Shqipe";
- Master Profesional në "Mësues në Arsimin e Mesëmtë Ulët për Gjuhën e Huaj Gjermane me profil minor në Gjuhën Shqipe";
- Master Profesional në "Drejtimit dhe Administrim Arsimit";
- Master i Shkencave në "Shërbime Sociale";
- Master i Shkencave në "Psikologji Arsimore";
- Master i shkencave në "Mësuesi për Gjuhë angleze";
- Master i shkencave në "Mësuesi në gjuhë të huaj, Gjuhë frënge";
- Master i shkencave në "Mësuesi në Matematikë-Fizikë";
- Master i shkencave në "Mësuesi në Matematikë-TIK";
- Master i shkencave në "Mësuesi në Edukim fizik, Sport dhe Shëndet";
- Master i shkencave në "Mësuesi në Histori-Gjeografi";
- Master i shkencave në "Mësuesi për Biologji-Kimi";
- Master i Shkencave në "Mësuesi për Arsimin Fillor";
- Master i Shkencave në "Mësuesi për Gjuhën shqipe dhe letërsi".



4.3. Programet "Diplomë me karakter Profesional" në këtë fakultet përfshin:

- Program me karakter Profesional në "Edukatore për Fëmijët 0-3 Vjeç".

Struktura e Fakultetit të Shkencave të Edukimit

Departamentet:

- Departamenti i Shkencave Sociale dhe i Edukimit Qytetar.
- Departamenti i Psikologjisë.
- Departamenti i Edukimit Fizik dhe i Sporteve.
- Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies.
- Qendra për Kërkim dhe Zhvillim në Arsim.

5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ofron programe në ciklet e parë, të dytë dhe të tretë.

5.1. Cikli i Parë "Bachelor" përfshin:

- Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme".
- Bachelor në "Infermieri Mami";
- Bachelor në "Fizioterapi";
- Bachelor në "Logopedi";

- Bachelor në “Imazheri”;
- Bachelor në “Teknik Laboratori”

5.2. Cikli i Dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në këtë fakultet përfshijnë:

- Master Profesional në “Fizioterapi”;
- Master Profesional në “Logopedi”;
- Master Profesional në “Teknik Imazherie”;
- Master Profesional në “Teknik Laboratori”;
- Master Profesional në “Menaxhim Infermieror”;
- Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;
- Master i Shkencave në “Infermieri”;
- Master i Shkencave në “Mami”.

Struktura e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike

Departamentet :

- Departamenti i Infermieristikës;
- Departamenti i Lëndëve Preklinike;
- Departamenti i Lëndëve Klinike;
- Departamenti i Specialiteteve Teknike-Mjekësore.



Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ofron një portofol të larmishëm akademik, që përfshin programe të cilat janë në përputhje me nivelet 5, 6, 7, 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe me nivelet përkatëse të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Bashkërendimi i Kornizave të Kualifikimeve krijon mundësinë që studentët të marrin një shkollim akademik që i përmbush standardet kombëtare dhe evropiane dhe janë të aftë të integrohen në nivel profesional dhe të suksesshëm në kontekstin bashkëkohor të tregut të punës.

- Programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor” në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” janë të hartuara për të arritur shkallën më të lartë të kualifikimit profesional, me fokus në:
 - dije themelore në disiplina të ndryshme;
 - trajnimin e studentëve në licencat profesionale dhe në drejtimet e specializuara;
 - diploma profesionale në përputhje me nevojat e tregut të punës;
 - edukimin qytetar për të nxitur përgjegjësinë sociale dhe qytetarinë aktive;
 - aftësitë personale dhe profesionale;
 - përgatitjen për studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”.
 - nxitjen e mendimit kritik dhe të kërkimit shkencor në hartimin e temave të diplomës ose provimeve shtetërore.
- Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” janë hartuar duke pasur synim përgatitjen e studentëve për të përballuar sfida të ndryshme profesionale dhe akademike si:
 - dije të thelluara dhe ekspertizë në fushën e zgjedhur të studimit;
 - kërkim shkencor të pavarur, duke nxitur mendimin kritik dhe inovacionin;
 - licencim profesional, në përmbushje të kërkesave të profesioneve të rregulluara dhe paisjen e studentëve të diplomuar me certifikatat e nevojshme;
 - zhvillimin e karrierës dhe rritjen profesionale;

- gërshetimine mësimdhënies me praktikën në kompanitë prestigjioze duke u ofruar përvojë tëvlefshme praktike;
 - përgatitjen për studimet doktorale, me fokus kërkimin shkencor;
 - teza e diplomës, si një produkt i origjinal qëintegron kërkimin teorik, empirikkreativitetin, aftësitë akademike të studentitnë përfundim të studimeve.
- c. Programet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”u ofrojnëstudentëve nivelin më të lartë akademik të shkollimit.

Karakteristikat themelore të programeve të doktoratës përfshijnë:

- kërkimin shkencor të thelluar me kontribute origjinale në fushën e studimit;
- ekspertizën e specializuar e cila përgatit studentët të integrohen në botën akademike dhe atë të biznesitfalëaftësive të zhvilluara të lidërshipt dhe të sipërmarrjes;
- disertacionin dhe botiminme cilësi të lartë shkencore, si akt finaltë studimit doktorale, duke u ofruar mundësi botimi në buletinet shkencore universitare.

Universiteti i Elbasanit është promotor i cilësisë akademike duke ofruar një gamë të gjerë programesh qëmbështesin zhvillimin personal e profesional të studentëve dheintegrimin e tyre të suksesshëm në tregun e punës.

Universiteti aderon të zhvillohet si njëinstitucion i rëndësishëmnë nivel kombëtar, rajonale më gjerë,i fokusuar në shërbime arsimore qëplotësojnë standardet evropiane.



ANALIZA SOT: PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT PËR UNIVERSITETIN E ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”



1. Pikat e forta dhe avantazhet e universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka punuar fort për krijimin e reputacionit si institucion avangard në arsimin e lartë. Puna e tij konsiston në drejtimet thelbësore të misionit të universitetit, të cilat janë të konsoliduara dhe nxisin zhvillimin akademik, inovativ në mënyrë të vazhdueshme dhe të suksesshme.

- 1. Reputacion i konsoliduar:** Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka mbi katër dekada përvojë në arsimin e lartë, duke u bërë një nga institucionet më të rëndësishme në Shqipëri.
- 2. Baza e fortë historike:** Si institucioni i parë kombëtar për trajnimin e mësuesve në Shqipëri, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit arsimor parauniversitar dhe universitarshqiptar.
- 3. Akreditimi dhe sigurimi i cilësisë:** Akreditimi i institucionit për periudhën 2020-2026 është shtysë e mëtejshme për të ruajtur standardet e cilësinë akademike. Për më tepër, procesi në vazhdim për akreditimin e gjitha programeve të studimit, forcon përkushtimin e tij për t'u rritur në nivel akademik e profesional.
- 4. Cilësia e personelit akademik:** Staf i akademik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” njihet dhe vlerësohet për ekspertizën, angazhimin dhe kontributet e tij në komunitetet akademike kombëtare dhe ndërkombëtare. Kualifikimet, aktivitetet, projektet kërkimore dhe angazhimi i tij në rrjete të ndryshme akademike profesionale, përmirësojnë reputacionin e institucionit dhe sigurojnë ofrimin e një arsimi cilësor.
- 5. Personeli akademik me kohë të plotë:** Ky staf përbëhet nga profesorë, profesorë të asociuar, asistentë profesorë, lektorë të cilët kontribuojnë në nivelin akademik të universitetit përmes ekspertizës, kërkimit dhe angazhimit për progresin e studentëve. Universiteti ka prioritet zhvillimin profesional të vazhdueshëm për të siguruar që stafi akademik të mbetet në krye të standardeve dhe risive akademike.
- 6. Oferta e gjerë akademike:** Universiteti ofron një gamë të gjerë programesh studimi në të gjitha ciklet akademike - Bachelor, Master dhe Doktoratë, si dhe programe me karakter profesional që përmbushin nevojat akademike dhe të tregut të punës - përfshirë fusha, si: Biznesi, Juridike, Shkencat Natyrore, Shkencat Humane, Shkencat e Edukimit dhe Shkencat Mjekësore Teknike. Disa programe janë të hartuara me një qasje ndërdisiplinore. Programet e studimit karakterizohen nga rigorozi shkencor akademik, qasje profesionale të studentëve ndaj prirjeve të tregut të punës dhe biznesit.
- 7. Fokusi te studentët:** Vëmendje e shtuar ndaj studentëve, duke promovuar rritjen personale dhe profesionale, e cila nxit zhvillimin akademik, integritetin dhe gjithëpërfshirjen.
- 8. Qasje në literaturën bashkëkohore dhe burimet digjitale të bibliotekës:** Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” uofron studentëve dhe personelit akademik qasje në koleksione të literaturës bashkëkohore dhe një bibliotekë digjitale të teknologjisë së

fundit duke bërë të mundur që kërkimi shkencor dhe mësimdhënia të mbështeten që burime të shumta disiplinash.



9. **Infrastruktura, laboratorët, qendrat:** Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" disponon një infrastrukturë moderne, e cila mbështet një mjedis dinamik dhe inovativ të të nxënit. I pajisur me laboratorë modernë, qendra kërkimore dhe mjedise të specializuara, krijon mundësi që studentët dhe stafi akademik të kenë qasje në teknologjitë dhe zhvillimet më të fundit në disiplina të ndryshme. Ato luajnë rol thelbësor në nxitjen e të nxënit dhe aftësive praktike, kërkimit shkencor të thelluar, kërkesa të nevojshme për tregun ndërkombëtar të punës. Për më tepër, universiteti investon vazhdimisht në përmirësimin e infrastrukturës për t'iu përshtatur nevojave të tij dhe kontekstit bashkëkohor.
10. **Vizibiliteti ndërkombëtar:** Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" synon të rrisë vizibilitetin e tij ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, shkëmbimeve akademike dhe pjesëmarrjes në nisma kërkimore. Duke bashkëpunuar me universitete dhe organizata prestigjioze në mbarë botën, universiteti promovon një mjedis akademik multikulturor që pasuron përvojën e mësimdhënies për studentët dhe stafin. Angazhimi i tij aktiv në projekte ndërkombëtare, shkëmbime të personelit akademik si dhe nisma Erasmus+ evidenton përpjekjen për të promovuar shpërndarjen e dijeve dhe inovacionin. Ky orientim jo vetëm përmirëson profilin e universitetit në kontekstin arsimit ndërkombëtar, por gjithashtu pajis të diplomuarit me kompetencat, perspektivat e nevojshme për të pasur sukses në to.
11. **Zhvillimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit përmes projekteve kombëtare dhe evropiane:** Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" promovon kërkimin dhe inovacionin përmes pjesëmarrjes në projekte të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), programet të ndryshme evropiane si psh. Programi Evropian për Kërkimin Shkencor dhe Teknologjinë COST. Këto iniciativa i mundësojnë universitetit që të angazhohet në kërkime ndërdisiplinore, të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të kontribuojë në adresimin e sfidave komplekse globale. Duke siguruar grante konkurruese dhe duke marrë pjesë në rrjete kërkimore prestigjioze, universiteti kontribuon në ngritjen e kapaciteteve akademike kërkimore dhe ofron mundësi të vlefshme për stafin akademik dhe studentët për të zhvilluar ekspertizën e tyre.
12. **Përshtatja strategjike me standardet kombëtare dhe evropiane:** Strategjia përputhet me Strategjinë Kombëtare të Shqipërisë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë dhe objektivat më të gjera të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Përkushtimi për ndërkombëtarizim dhe integrim në EHEA forcon aftësinë për t'u integruar, promovuar dhe konkurruar në kontekste të barazvlefshme universitare.
13. **Planet e zhvillimit institucional:** Fokus i qartë në përmirësimin e mësimdhënies, kërkimit, inovacionit dhe shërbimeve digjitale përmes zhvillimit të mëtejshëm dhe modernizimit të infrastrukturës.

2. Pikat e dobëta të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Pavarësisht zhvillimit të gjithanshëm në kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ka përcaktuar fushat që kërkojnë përmirësim. Identifikimi i tyre ofron mundësi për universitetin që të adresojë sfidat, të përmirësojë performancën e tij dhe të forcojë pozicionin si një institucion avangard në Arsimin e Lartë.

Akreditimi në proces për disa programe: Megjithëse shumë programe janë të akredituara, ende disa programenuk e kanë përfunduar procesin e akreditimit.



1. Infrastruktura dhe mangësitë teknologjike: Për t'i realizuar objektivat e tij strategjike, universiteti po modernizon infrastrukturën dhe sistemet administrative, përmasa teknologjisë. Fokusi kryesor i këtij modernizimi është integrimi i shërbimeve të avancuar digjitale, një nismë e planifikuar me kujdes e cila konsiston në investime të konsiderueshme fizike dhe digjitale në infrastrukturë. Ato mundësojnë zhvillimin e objektivave ambicioze për ndërkombëtarizimin e universitetit, i cili përbën themelin e planit të tij strategjik. Gjithashtu përpjekja e vazhdueshme për të rritur vizibilitetin ndërkombëtar dhe zgjerimin e partneriteteve, e nxit për të konkurruar në mënyrë dinjitoze me universitetet kombëtare e qendrat ndërkombëtare.

2. Mundësitë e universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

- 1. Rritja e tregut ndërkombëtar të studentëve:** Strategjia synon tërheqjen e studentëve të huaj, duke e pozicionuar universitetin “Aleksandër Xhuvani” si një institucion konkurrues në arsimin e lartë shqiptar dhe në rajonin e Ballkanit. Forcimi i partneriteteve ndërkombëtare mund të hapë dyert për programe të përbashkëta të diplomave, shkëmbim studentësh dhe bashkëpunime kërkimore.
- 2. Cilësia e kërkimit dhe e inovacionit:** Rritja e fokusit në kërkimin shkencor dhe inovacionin, veçanërisht në fushat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, transformimin digjital dhe bashkëpunimin e biznesit me institucionet e arsimit të lartë, paraqet mundësinë për t'u bërë lider në to.
- 3. Transformimi digjital:** Zhvillimi i shërbimeve digjitale dhe i platformave elektronike të mësimdhënies krijojnë mundësi për akses efleksibilitet më të madh, në ofrimin e shërbimeve dhe zgjerimin e programeve të studimit që aplikohen *online*.
- 4. Mbështetja e qeverisë dhe BE-së:** Përafrimi i Strategjisë së Universitetit me Strategjitë Kombëtare të Arsimit dhe të BE-së e vendos në pozicion të favorshëm për të tërhequr fonde shtesë dhe mbështetje për projektet kërkimore, për zhvillimin e infrastrukturës dhe inovacionit.
- 5. Programet e të nxënës gjatë gjithë jetës:** Zhvillimi i programeve të të nxënës gjatë gjithë jetës dhe kurseve të zhvillimit profesional krijojnë mundësinë e rritjes së numrit të studentëve të regjistruar, siguron një burim shtesë të ardhurash, e njëkohësisht zgjeron shtrirjen demografike përtej zonave urbane e rurale që tradicionalisht ndjekin universitetin “Aleksandër Xhuvani”.
- 6. Bashkëpunimet në mësimdhënie dhe kërkime shkencore:** Reputacioni akademik i universitetit, mund të shfrytëzohet për të ndërtuar partneritete strategjike me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Rreziqet e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

- 1. Largimi i trurit:** Largimi i të diplomuarvetë suksesshëm për studime jashtë vendit, zvogëlon impaktin e universitetit për të tërhequr në programet e tij këtë kategori të studentëve, duke ndikuar në performancën dhe reputacionin e tij akademik.
- 2. Ndryshimi i kërkesave të tregut të punës:** Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, i biznesit, krijojnë mospërputhje midis programeve akademike dhe nevojave në ndryshim të tregut të punës. Ai ndikon në punësimin diplomuarve e njëkohësisht në realizimin e kërkesave dhe pritshmëritë e kandidatëve për studentë gjatë procesit të regjistrimit.

3. **Mundësi të kufizuara financimi për kërkimin shkencor:** Konkurrenca e lartë për financimin e kërkimit shkencor, veçanërisht nga burimet ndërkombëtare, mund të kufizojë mundësitë e universitetit për të financuar projekte inovative dhe për të zgjeruar kapacitetin e tij kërkimor.
4. **Ndryshimet sociale dhe demografike:** Ndryshimet lokale dhe rajonale të popullsisë, të tilla si rënia e lindjeve ose migrimi, mund të zvogëlojnë target-grupin e studentëve të ardhshëm në universitet, duke ndikuar te regjistrimi dhe diversiteti i tyre, veçanërisht në fusha specifike studimi.
5. **Sfidat mjedisore:** Ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe sfidat mjedisore mund të paraqesin rreziqe të konsiderueshme për infrastrukturën e kampusit dhe të aktiviteteve akademike, nëse nuk përditësohen vazhdimisht praktikatat e qëndrueshmërisë së universitetit.
6. **Zhvillimet teknologjike në arsim:** Zhvillimet e shpejta teknologjike, të tilla si aplikimi i inteligjencës artificiale në mësimdhënie ose mësimdhënia *online/* distancë përmes klasave virtuale, mund të tejkalojnë aftësinë e universitetit për t'i integruar dhe përshtatur këto risi në kurrikul dhe në infrastrukturën e tij.



4. Vizioni, misioni dhe fokusi strategjik i universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për vitet 2024-2028

6.1.Vizioni

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” aspirojnë të jetë ndër institucionet më të rëndësishme akademike në Shqipëri dhe rajon, si promotor i cilësisë akademike, i inovacionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Ky vizion do të përmirësojë në mënyrë aktive renditjen e tij ndërkombëtare, duke pasur njësi matëse performancën në mësimdhënien akademike, cilësinë e kërkimit shkencor dhe ndikimit global.

Me ekspertizën e tij ai është në gjendje të kuptojnë mënyrë vizionareorientimin e sistemit arsimor shqiptar dhe të kërkimit shkencor në të ardhmen, dhe të drejtojë punën e tij drejt këtij orientimi duke kontribuar ndjeshëm në sfidat me të cilat përballet shoqëria jonë.

6.2.Misioni

Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ofron mësimdhënie cilësore, promovon kërkimin inovativ të ekselencës akademike, duke zgjeruar aksesin në burime e partneritete përmes mundësive fleksibël si dhe nxit një kulturë të gjithëpërfshirjes për studime dhe kërkime.

Universiteti është i përkushtuar të pajisë studentët me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të ndërtuar një karrierë të suksesshme në një shoqëri të globalizuar. Gjithashtu ai kërkon të zgjerojë aftësitë e tij kërkimore përmes partneriteteve strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, të rrisë kontributin e tij në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik dhe të përmirësojë vizibilitetin e renditjen e tij ndërkombëtare.

Duke nxitur një mjedis vizionar e dinamik të të nxënimit dhe të kërkimit shkencor, universiteti synon të bëhet i njohur si institucion pararojë me studentë të diplomuar, të të gjitha niveleve, në të gjitha programet e studimit Bachelor, Pasuniversitar dhe PhD.

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për të përmbushur misionin e tij, do të përshtatë e përmirësojë vazhdimisht programet e studimit bazuar në:

- nevojat e shoqërisë;
- në kontekstin global;
- në zhvillimet akademike;
- në nismat kërkimore;
- partneritetet;

për të adresuar si duhet sfidat dhe mundësitë e botës moderne.

Puna e tij, do të fokusohet diplomimin e studentëve të pajisur me kompetenca të nevojshme, për të dhënë kontribute kuptimplotë në sektorë të ndryshëm jetësorë, siç janë menduarit kritik, zgjidhja e problemeve dhe aftësitë drejtuese.

Ai do t'i japë përparësi zhvillimit të kërkimit shkencor inovativ që përputhet me prioritetet kombëtare dhe tendencat globale, me qëllim nxitjen e zhvillimit shoqëror e të qëndrueshëm dhe rritjen ekonomike.

Universiteti do të promovojë të nxënit gjatë gjithë jetës dhe do të nxisë një kulturë të inovacionit dhe të sipërmarrjes përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, me në qendër studentin.

Për të përmbushur misionin, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" do të fokusohet në katër vitet e ardhshme në këto prioritetet strategjike:

1. Rritja e cilësisë akademike dhe njohjes globale:

- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të universitetit nëpërmjet partneriteteve strategjike dhe shkëmbimeve akademike, duke synuar diploma të dyfishta në të gjitha nivelet e studimit (Bachelor, Master, Ph.D.);
- Përmirësimi i vizibilitetit dhe renditjes ndërkombëtare duke i zgjeruar programet pasuniversitare dhe të doktoratës në fusha ndërdisiplinore dhe multidisiplinore;
- Ofrimi i mësimdhënies me cilësi të lartë në të gjitha nivelet përmes promovimit të një kulture kërkimore shkencore që kontribuon në adresimin e sfidave globale dhe lokale;
- Hartimi i kurrikulave me një qasje ndërkulturore që i pajis studentët të përgatiten dhe të përshtaten me çdo treg pune duke iu përmbajtur parimeve të gjithëpërfshirjes;
- Zbatimi i mekanizmave rigoroze/cilësorë të monitorimit dhe të vlerësimit për publikimet/botimet me akses të hapur dhe të dhënat shkencore;
- Zhvillimi i një strategjie institucionale për të promovuar e politikën e botimeve shkencore me akses të hapur, duke e integruar në politikat ekzistuese të zhvillimit akademik dhe atij kërkimor;
- Krijimi i një sistemi raportimi periodik për progresin e nismave dhe projekteve kërkimore shkencore me akses të hapur brenda universitetit, duke siguruar transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm.

2. Rritja e kërkimit dhe inovacionit:

- Zgjerimi i agjendës kërkimore me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm, transformimin digjital dhe studimet ndërdisiplinore;
- Rritja e pjesëmarrjes në programet kërkimore evropiane dhe ato ndërkombëtare;
- Nxitja e lidhjeve më të ngushta me biznesin për kërkime të aplikuara për të nxitur inovacionin dhe ndikimin shoqëror;
- Përsheptimi i tranzicionit drejt publikimeve/botimeve me akses të hapur për stafin akademik dhe studentët në të gjitha ciklet e studimit;
- Përmirësimi i infrastrukturës së platformës institucionale të Buletinit Shkencor për të lejuar botime/publikime shkencore me akses të hapur dhe ndarjen e të dhënave;



- Mbështetja e pjesëmarrjes së studiuesve në rrjetet shkencore që promovojnë publikimet/botimet me akses të hapur;
- Krijimi i kornizave dhe zhvillimi i mekanizmave institucionalë për menaxhimin dhe shpërndarjen e të dhënave me akses të hapur sipas standardeve ndërkombëtare.

3. Ndërkombëtarizimi dhe konkurrenca globale:

- Forcimi i vizibilitetit ndërkombëtar duke u bërë pjesë e rrjeteve kërkimore akademike ndërkombëtare;
- Krijimi i programeve të përbashkëta akademike dhe tërheqja e studentëve ndërkombëtarë;
- Përafrimi me Strategjitë Kombëtare dhe Evropiane të Arsimit të Lartë, duke e pozicionuar universitetin si një aktor të rëndësishëm në komunitetin akademik ndërkombëtar;
- Krijimi i partneritetit me universitete dhe institute kërkimore që promovojnë praktika të hapura;
- Përsheptimi i integritetit në rrjetet akademike që mbështesin aksesin e hapur në njohuritë shkencore;
- Mbështetja e studentëve dhe stafëve akademike në fakultete për të publikuar punën e tyre kërkimore shkencore në revista me akses të hapur;
- Hartimi i politikave dhe partneriteteve ndërkombëtare që nxisin shkëmbimin e njohurive përmes metodave të hapura shkencore.

4. Përsheptimi i transformimit digjital:

- Zhvillimi i platformave të mësimi online/ në distancë, programeve e-learning dhe klasave virtuale për të rritur aksesin dhe fleksibilitetin;
- Përkujdesje ndaj nevojave dhe formave të ndryshme të të nxënës dhe duke e përshtatur procesin e mësimdhënies akademike dhe të nxënës me kërkesat e shoqërisë moderne.

5. Zhvillimi i fuqisë punëtore (profesionistëve) dhe të nxënës gjatë gjithë jetës:

- Zgjerimi i programeve të të nxënës gjatë gjithë jetës dhe kurseve të zhvillimit profesional për profesionistë, alumni dhe individët që kërkojnë të ndërrojnë profesion;
- Kontributi në edukimin e vazhduar të komunitetit në nivel gjithëpërfshirës, duke mbështetur zhvillimin e fuqisë punëtore(profesionistëve) në Shqipëri.

6. Zhvillimi i infrastrukturës dhe kampusit:

- Modernizimi i mjediseve të kampusit, duke përfshirë zgjerimin/ pajisjen me mjete bashkëkohore të laboratorëve kërkimorë dhe përmirësimin e shërbimeve për studentët;
- Krijimi i hapësirave inovative të favorshme për të studiuar/nxënë, investimi në pajisje digjitale dhe biblioteka moderne për të mbështetur iniciativat e kërkimit shkencor akademike.

7. Zhvillimi i një strategjie të etikës në kërkimin shkencor dhe sjelljen

- Forcimi i ndershmërinë akademike, integritetit shkencor dhe respektit për të drejtat themelore të njeriut.
- Respektimi i parimeve të Open Science dhe dominimi i njeriut mbi inteligjencën artificiale.
- Promovimi i transparencës, lirisë akademike dhe ndarjen e hapur të njohurive për të forcuar inovacionin dhe zhvillimin shkencor.



Realizimi i prioriteteve strategjike të mësipërme do të sigurojë që Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të kthehet në një qendër të ekselencës akademike, inovacionit dhe konkurrencës ndërkombëtare, duke kontribuar në thellimin e njohurive, zhvillimin e shoqërisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit arsimit të lartë shqiptar.

7. Qëllimet/synimet dhe objektivat strategjike për avancimin e cilësisë akademike, inovacionit dhe konkurrencës globale

7.1. Qëllimi

Të bëhet Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” një qendër e ekselencës akademike, inovacionit dhe konkurrencës globale, duke kontribuar në thellimin e njohurive, zhvillimin e shoqërisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të arsimit të lartë shqiptar.

7.2. Objektivat strategjike

1. Rritja e cilësisë akademike:

- Të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme cilësia e mësimdhënies dhe të nxënimit në të gjitha programet, duke garantuar përmbushjen e standardeve ndërkombëtare;
- Të forcohet integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor, duke nxitur një mjedis që promovon të menduarit kritik dhe inovacionin;

2. Zgjerimi i kërkimit dhe inovacionit:

- Të rritet aktiviteti i kërkimit shkencor duke u fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm, transformimin digjital dhe studimet ndërdisiplinore;
- Të zgjerohet pjesëmarrja e universitetit në programet kërkimore evropiane dhe ndërkombëtare, duke promovuar bashkëpunimin me biznesin/industrinë për të nxitur kërkimin e aplikuar;
- Të promovohet shkenca e hapur si pjesë integrale e strategjisë së saj të zhvillimit të kërkimit dhe të inovacionit duke u bërë pjesë e kulturës akademike të tij.

3. Promovimi i ndërkombëtarizimit dhe konkurrencës globale:

- Të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar i universitetit nëpërmjet partneriteteve strategjike, shkëmbimeve akademike dhe zhvillimit të programeve të dyfishta në të gjitha nivelet akademike (Bachelor, Master, Ph.D.);
- Të rritet vizibiliteti i universitetit me anë të pjesëmarrjes në rrjetet akademike dhe kërkimore ndërkombëtare të Arsimit të Lartë, si dhe duke tërhequr studentë ndërkombëtarë;
- Të unifikohen strategjitë kërkimore të Universitetit të Elbasanit me rekomandimet e UNESCO-s për shkencën e hapur.

4. Përsheptimi i transformimit digjital:

- Të konsolidohet përdorimi i teknologjisë dhe i platformave digjitale në mësimdhënie përmes zhvillimit të platformave të mësimi *online*, programeve të studimit në distancë dhe klasave virtuale;
- Të integrohen mjetet më të avancuara digjitale në procesin e mësimdhënies akademike, për ta bërë atë më të aksesueshëm, fleksibël dhe më të përgjegjshëm ndaj nevojave të shoqërisë moderne;
- Të sigurohet akses i lirë dhe i gjerë i tyre në njohuritë akademike.

5. Mbështetja në zhvillimin e profesionistëve dhe të nxënimit gjatë gjithë jetës:



- Të zgjerohen programet e zhvillimit profesional, të arsimit të vazhduar dhe kurset e të nxënit gjatë gjithë jetës në mbështetje të nevojave të ndryshme të profesionistëve, të të diplomuarve atyre që kërkojnë të ndërrojnë profesion;
 - Të forcohet roli i universitetit në zhvillimin e profesionistëve rajonalë dhe kombëtarë duke ofruar programe studimi koherente, efektive dhe me ndikim.
- 6. Investimi në zhvillimin e infrastrukturës dhe kampusit:**
- Të modernizohen mjediset e kampusit, duke përfshirë zgjerimin e laboratorëve kërkimorë, shërbimeve ndaj studentëve dhe krijimin e hapësirave që inkurajojnë inovacionin dhe bashkëpunimin;
 - Të investohet në burime digjitale, biblioteka dhe objekte kërkimore moderne për të mbështetur aktivitetet mësimore dhe kërkimore.
- 7. Përmirësimi i vizibilitetit në nivel global dhe renditjen ndërkombëtare:**
- Të rritet vizibiliteti i universitetit dhe renditjes ndërkombëtare të tij, duke zgjeruar programet pasuniversitare dhe të doktoratës në fusha ndërdisiplinore dhe multidisiplinore;
 - Të zhvillohen iniciativa për të nxitur një kulturë akademike të orientuar drejt kërkimit shkencor që përputhet me standardet ndërkombëtare dhe që kontribuon në thellimin e njohurive.
- 8. Zhvillimi i një strategjie të etikës në kërkimin shkencor dhe sjelljen**
- Të forcohet ndershmëria e pavarësia akademike, integriteti shkencor dhe respekti për të drejtat themelore të njeriut.
 - Të respektohen parimet e Open Science dhe dominimi i njeriut mbi inteligjencën artificiale.
 - Të promovohet transparenca, liria akademike dhe ndarja e hapur e njohurive për të forcuar inovacionin dhe zhvillimin shkencor.
 - Të promovohet kultura e etikës në komunikim, sjellje dhe vendimmarrje për të përmirësuar efikasitetin, transparencën, ndershmërinë akademike profesionale dhe institucionale.



SO1. Rritja e cilësisë akademike

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është i përkushtuar të punojë drejt rritjes së cilësisë akademike, duke përmirësuar vazhdimisht praktikën e tij në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Kjo do të arrihet duke u siguruar që të gjitha programet arsimore të përmbushin ose tejkalojnë standardet ndërkombëtare, duke u ofruar studentëve një mësimdhënie cilësore dhe konkurruese. Universiteti do të investojë në zhvillimin e fakulteteve, duke ofruar mundësi për stafin akademik të përmirësojë aftësitë pedagogjike, të jetë në koherencë me prirjet më të reja të mësimdhënies dhe me zhvillimet teknologjike. Për më tepër, kurrikulat do të rishikohen dhe përditësohen rregullisht duke pasqyruar nevojat në zhvillim të shoqërisë dhe tregut të punës, duke përfshirë praktikën më të mira ndërkombëtare në arsimin e lartë.

Gjithashtu universiteti synon të forcojë integritetin e kërkimit shkencor me mësimdhënien, duke nxitur një mjedis në të cilin studentët, pedagogët dhe studiuesit të bashkëpunojnë në gjenerimin e ideve të reja. Studentët do të fitojnë njohuri teorike, do të zhvillojnë të menduarit kritik dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve përmes gërshetimit të kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies. Edukimi i orientuar drejt kërkimit shkencor, do t'i inkurajojë studentët të angazhohen me sfidat bashkëkohore, duke zhvilluar zgjidhje inovative që mund të zbatohen në kontekstet e botës reale. Nëpërmjet këtij fokusi strategjik, universiteti do të krijojë

një kulturë akademike që e ka prioritet kërkimin shkencor, mendimin kritik, kreativitetin dhe integritetin akademik, duke i përgatitur të diplomuarit të bëhen liderë dhe novatorë në fushat e tyre përkatëse.

Për të arritur SO1, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” duhet të zbatojë këto masa konkrete:

1. Zhvillimi dhe modernizimi i kurrikulës:

- Rishikimi dhe përditësimi rregullisht kurrikulave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe nevojat e tregut të punës;
- Integrimi i metodave novatore në mësimdhënie, të tilla si mësimi i bazuar në zgjidhjen e problemeve dhe të nxënët nëpërmjet eksperimenteve, për të nxitur angazhimin e studentëve dhe të menduarit kritik;
- Zhvillimi i programeve ndërdisiplinore që adresojnë sfidat bashkëkohore globale, si: ndryshimi i klimës, digjitalizimi dhe gjithëpërfshirja sociale.

2. Zhvillimi i fakulteteve:

- Investimi në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik, duke përfshirë trajnime me metodat moderne pedagogjike dhe mjetet digjitale;
- Inkurajimi i fakulteteve që stafi tyre të kualifikohet duke ndjekur trajnime e diploma të avancuara, certifikime dhe përvoja ndërkombëtare të mësimdhënies;
- Zbatimi i programeve të mentorimit për të mbështetur stafet e reja akademike të fakulteteve në kërkimin shkencor dhe zhvillimin aftësive pedagogjike e metodologjike për të rritur cilësinë e mësimdhënies.

3. Sigurimi i cilësisë:

- Forcimi i mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë duke kryer vlerësime periodike të programeve, rishikime e përmirësime nga stafet akademike dhe anketime të studentëve;
- Synimi i akreditimit ndërkombëtar për programet e studimit duke garantuar përmbushjen standardeve ndërkombëtare;
- Krijimi i *Qendrës Akademike të Ekselencës* për të mbështetur fakultetet në përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe të rezultateve kërkimore.

4. Mjedisi mësimor me në qendër studentin:

- Nxitja e një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës dhe mbështetës, duke zbatuar politika që sigurojnë qasje të barabartë në burime dhe mundësi për të gjithë studentët;
- Zgjerimi i mundësive për pjesëmarrjen e studentëve në projekte kërkimore, praktika dhe aktivitete mësimore të bazuara në komunitet;
- Ofrimi i konsultimeve e këshillimeve të karrierës akademike për të mbështetur studentët në arritjen e qëllimeve të tyre në nivelet e arsimimit dhe të karrierës.

5. Integrimi i kërkimit në mësimdhënie:

- Përfshirja e komponentëve të kërkimit në programet universitare dhe pasuniversitare për të kultivuar aftësi analitike dhe për zgjidhjen e problemeve;
- Promovimi i kërkimit i udhëhequr nga stafet akademike në fakultete duke përfshirë studentët si bashkëpunëtorë, për t'u ofruar përvoja praktike dhe praktika të ndryshme të të nxënët;



- Organizimi i simpoziumeve vjetore të karrierës, konferencave kërkimore dhe konkurseve për studentët, duke bërë të mundur integrimin e tyre me anë të kompetencave, arritjeve krijuese e akademike në tregun e punës.

6. Ndërkombëtarizimi i arsimit:

- Krijimi i partneriteteve me universitete të huaja për të zhvilluar programe të përbashkëta, iniciativa shkëmbimi dhe mundësi për diploma të dyfishta;
- Integrimi i rasteve të studimit dhe perspektivave ndërkombëtare në kurrikula për të përgatitur studentët drejt një konteksti global;
- Ftesa e lektorëve ndërkombëtarë për shkëmbimin e njohurive, praktikave dhe përvojave të ndryshme.

7. Zhvillimi i infrastrukturës mësimore

- Modernizimi i mjediseve të auditorëve me teknologji inovative, për të nxitur e stimuluar stile të ndryshme të të nxënit si, p.sh., ndërveprues dhe hibrid;
- Zgjerimi i aksesit në burimet e literaturës dhe materialeve mësimore nëpërmjet teknologjisë, bibliotekave digjitale, platformave e mësimdhënies *online*;
- Krijimi i hapësirave bashkëpunuese në kampus për realizimin e punës në grup, aplikimit të inovacionit dhe shkëmbimit të njohurive.

8. Njohja dhe stimujt:

- Zhvillimi i programeve vlerësuese për rezultatet e larta akademike të studentëve dhe stafit akademik;
- Prezantimi i konceptit të çmimeve vlerësuese ose granteve duke aplikuar në programet evropiane për inovacionin e fakulteteve, ekselencën e mësimdhënies ose kërkimit.

Me zbatimin e këtyre masave, Universiteti i Elbasanit mund të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit, duke e bërë atë lider të cilësisë akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



SO2. Zgjerimi i kërkimit dhe inovacionit

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" njeh kërkimin dhe inovacionin si shtylla themelore për thellimin e njohurive dhe zhvillimin shoqëror. Për ta arritur këtë, Universiteti do t'i japë përparësi rritjes së aktivitetit kërkimor, veçanërisht në fusha kyçe, si: zhvillimi i qëndrueshëm, transformimi digjital dhe studimet ndërdisiplinare. Duke u fokusuar në këto fusha të rëndësishme, universiteti synon të adresojë sfidat urgjente globale duke kontribuar në zhvillimin e zgjidhjeve praktike që ndihmojnë shoqërinë në përgjithësi. Mbështetja e fakulteteve dhe e studentëve në ndërmarrjen e projekteve kërkimore me ndikim, do të jetë fokusi kryesor i kësaj përpjekjeje, duke theksuar nxitjen e bashkëpunimit midis disiplinave për të gjeneruar ide dhe qasje inovative.

Përveç rritjes së aftësive të brendshme kërkimore, Universiteti do të punojë për të zgjeruar pjesëmarrjen e tij në programet kërkimore evropiane dhe ndërkombëtare, për të ndërtuar partneritete të forta me institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe rrjetet kërkimore. Bashkëpunime të tilla do t'i mundësojnë Universitetit të aksesojë metodologjitë, teknologjitë dhe financimet më bashkëkohore, duke e zgjeruar më tej agjendën e tij kërkimore. Një fokus i

veçantë do të vendoset gjithashtu, në promovimin e kërkimit të aplikuar përmes lidhjeve më të ngushta me biznesin, duke i mundësuar Universitetit të kontribuojë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe inovacionin teknologjik. Duke përafruar përpjekjet e tij kërkimore me nevojat e biznesit, Universiteti do të rrisë ndikimin e tij dhe do të krijojë mundësi për studentët që të angazhohen në përvoja praktike kërkimore. Këto nisma do ta pozicionojnë Universitetin e Elbasanit si lider në kërkimin dhe inovacionin, duke forcuar rolin e tij si një forcë lëvizëse për progres në Shqipëri dhe më gjerë.

Për të arritur këtë objektiv, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" do të zbatojë këto masa konkrete:

1. Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse kërkimore:

- Krijimi i një agjende kërkimore në të gjithë universitetin, e cila do të jetë e fokusuar në fusha të rëndësishme si zhvillimi i qëndrueshëm, transformimi digjital dhe studimet ndërdisiplinore;
- Dhënia përparësi temave kërkimore që përputhen me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, të tilla si: energjia e gjelbër, shkencat shëndetësore, shkencat humane digjitale dhe inovacioni social;
- Identifikimi i mundësive të financimit si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë evropian, si dhe zhvillimi i një udhërrëfyese për të siguruar grante kërkimore.

2. Rritja e kapacitetit kërkimor:

- Krijimi i qendrave ose i instituteve kërkimore që fokusohen në fusha prioritare, si: teknologjia, qëndrueshmëria dhe arsimi;
- Inkurajimi i formimit të ekipeve kërkimore ndërdisiplinore të përbëra nga pedagogë, studentë të cikleve të studimit pasuniversitar dhe studiues e bashkëpunëtorë të jashtëm.
- Rekrutimi i studiuesve ekspertë në fusha në zhvillim për të forcuar rezultatet e kërkimit dhe për të diversifikuar ekspertizën.

3. Rritja e pjesëmarrjes në programet kërkimore ndërkombëtare:


- Forcimi i partneriteteve me universitetet evropiane për të marrë pjesë në *Horizon Europe* dhe programe të tjera kërkimore të financuara nga BE;
- Hartimi i projekteve të përbashkëta kërkimore me institucionet ndërkombëtare për të shpërndarë dijen dhe për të nxitur inovacionin;
- Krijimi i njëzyretë dedikuar shkrimit e hartimit të projekteve kërkimore për të ndihmuar fakultetet në identifikimin e mundësive të financimit, përgatitjen e propozimeve dhe menaxhimin e projekteve të granteve.

4. Nxitja e bashkëpunimit me biznesin:

- Përforcimi i Bordit të Biznesit dhe vazhdimi të ndërtimit të partneriteteve me industrinë dhe biznese të reja, për të promovuar kërkimin e aplikuar që trajton probleme të përditshmërisë në jetën reale;
- Zhvillimi i nismave të përdorimit të teknologjisë me qëllim që gjetjet kërkimore të përkthehen në aplikime dhe zgjidhje praktike;
- Krijimi i një "Qendre Inovacioni" brenda Universitetit për të lidhur studiuesit, studentët dhe palët e interesuara të biznesit/ industrisë.

5. Forcimi i infrastrukturës për kërkime:

- Investimi në laboratorë modernë të pajisur me teknologji të përparuar për të mbështetur kërkime të thelluara në shkencë, teknologji dhe fusha të tjera:



- Zgjerimi i aksesit në burime digjitale me cilësi të lartë, si: revistat *online*, bazat e të dhënave kërkimore dhe instrumentet analitike;
- Sigurimi i mbështetjes financiare për blerjen e pajisjeve dhe softuerëve të specializuar për aktivitete kërkimore.

6. Mbështetja e studentëve dhe stafit akademik në kërkimin shkencor:

- Prezantimi i konceptit të granteve konkurruese kërkimore për stafin akademik të fakulteteve dhe studentët e programeve pasuniversitare me qëllim inkurajimin projekteve inovative, të cilat burojnë nga programe të ndryshme evropiane;
- Sigurimi i fondeve për stafet akademike të fakulteteve për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe për të botuar në revista të indeksuara në *Scopus*, *Web of Science*, *Scimago* etj;
- Nxitja e doktorantëve për të aplikuar për fondet e AKKSHIT, të cilët e kanë të fokusuar kërkimin në fusha strategjike.

7. Promovimi i shpërndarjes së dijes:

- Organizimi periodik i konferencave kërkimore, simpoziumeve dhe *workshop*-eve për të prezantuar rezultatet e kërkimore të stafit akademik të fakulteteve dhe të studentëve;
- Botimi periodik në Buletin Shkencor të Universitetit, (një revistë shkencore me standarde të vlerësimit kolegial- peer review) i rezultateve kërkimore të studentëve me qëllim rritjen e vizibilitetit të punës së tyre kërkimore;
- Nxitja për të botuar në revista me akses të hapur dhe për të marrë pjesë në platformat globale të shkëmbimit të njohurive.

8. Nxitja e sipërmarrjes dhe inovacionit:

- Krijimi i një programi mbështetës për auditorët eksperimentalë ose *startup*-eve për të inkurajuar stafin akademik të fakulteteve dhe studentët të zhvillojnë zgjidhje inovative me potencial tregtar;
- Ofrimi i trajnimeve për të drejtat e pronësisë intelektuale, sipërmarrjen dhe komercializimin e rezultateve të kërkimit;
- Bashkëpunimi me agjencitë qeveritare dhe investitorët për të mbështetur *startup*-et e udhëhequra nga universitetet.

9. Stimulimi dhe shpërblimi i ekselencës në kërkimin shkencor:

- Prezantimi i konceptit të vlerësimit me çmime për kontributet e shkëlqyera kërkimore në fushat kryesore dhe aplikimi i tij në programet evropiane që e stimulojnë këtë kërkim me çmime/fonde;
- Stimulimi i stafit akademik për rezultate të rëndësishme kërkimore me stimuj vlerësues e lehtësues, si, p.sh., ngarkesat e reduktuara të mësimore etj;
- Zhvillimi një sistemi vlerësues renditës dhe njohës për të promovuar konkurrencën e shëndetshme dhe për të stimuluar studiuesit me performancë të lartë.

10. Impakti i monitorimit dhe vlerësimit të punës kërkimore:

- Krijimi një sistemi matës mbi impaktin projekteve kërkimore në rezultatet akademike, sociale dhe ekonomike;
- Vlerësimi i projekteve kërkimore, duke dhënë feedback për të përmirësuar iniciativat e ardhshme;
- Zhvillimi i indikatorëve të performancës për të siguruar përafrimin me qëllimet e fushave kërkimore të universitetit.



11. Plani iveprimit për zbatimin e shkencës së hapur:

- Organizimi i sesioneve informuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi shkencën e hapur dhe përfitimet e saj;
- Mbështetja e aktiviteteve dhe projekteve që promovojnë akses të hapur në dijen shkencore;
- Ngritja e një komisioni të posaçëm për të mbikëqyrur zbatimin e kësaj strategjie;
- Zhvillimi i një platforme institucionale për publikime dhe të dhëna të hapura, duke u mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Duke zbatuar këto masa, Universiteti i Elbasanit mund të zgjerojë ndjeshëm rezultatet e tij kërkimore, të forcojë pozicionin e tij si një qendër inovacioni dhe të kontribuojë në mënyrë domethënëse në zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare në dije dhe teknologji.

SO3. Promovimi i ndërkombëtarizimit dhe konkurrencës globale

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka angazhimin maksimal që të pozicionohet si një institucion akademik i njohur në nivel rajonal e global duke përkrahur ndërkombëtarizimin dhe duke rritur konkurrencën e tij në to. Boshti i kësaj përpjekjeje do të jetë forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar. Universiteti synon të ndërtojë partneritete strategjike me institucione me reputacion në mbarë botën, duke mundësuar shkëmbimin e dijeve, praktikave më të mira dhe burimeve akademike. Zhvillimi i programeve të diplomave të dyfishta në të gjitha nivelet arsimore - Bachelor, Master dhe Ph.D. do të jetë prioriteti themelor, me qëllim që t'u ofrojë studentëve një arsim që plotëson standardet ndërkombëtare dhe i pajis me aftësi konkurruese. Shkëmbimet akademike për studentët dhe stafin akademik gjithashtu do të jenë përparësi për të nxitur të nxënit ndërkulturor dhe bashkëpunimin në kërkimin shkencor.

Universiteti do të marrë pjesë aktivisht në rrjetet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimore për të rritur vizibilitetin e tij, e njëkohësisht duke e pozicionuar veten si një kontribuues i vlefshëm në dialogët akademikë dhe shkencorë të të gjitha niveleve.

Zgjerimi i pranisë së tij në këto rrjete, do t'i forcojë reputacionin dhe do t'i krijojë mundësi për financime të rëndësishme, partneritete dhe projekte bashkëpunuese. Për më tepër, Universiteti do të fokusohet në tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë duke ofruar programe me cilësi të lartë në standarde dhe të përshtatshme për çdo lloj konteksti, me mjedise e kampuse mikpritëse, që promovojnë kompetencën ndërkulturore.

Strategjia e ndërkombëtarizimit do të pasurojë përvojën akademike për të gjithë studentët, duke u ofruar atyre perspektiva dhe mundësi të ndryshme për t'u përfshirë në sfidat globale. Universiteti i Elbasanit do të forcojë pozicionin e tij si një institucion konkurrues dhe vizionar mbështetur në nismat e ndërmarra, duke kontribuar në cilësinë akademike kombëtare dhe atë ndërkombëtare.

Për të arritur këtë objektiv, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” do të zbatojë këto masa konkrete:

1. **Forcimi i partneriteteve ndërkombëtare:** Krijimi i bashkëpunimeve të reja strategjike me universitete dhe institucione kërkimore kryesore në mbarë botën. Përqendrimi në hartimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, programeve të shkëmbimit të



studentëve dhe programeve të studimeve të dyfishta për të rritur praninë globale të universitetit.

2. **Shtimi i pjesëmarrjes në rrjetet globale të kërkimit:** Inkurajimi i stafëve akademike në fakultete dhe studentëve për t'u bërë pjesë e rrjeteve kërkimore dhe projekteve të përbashkëta ndërkombëtare. Sigurimi i fondeve nga programe kërkimore ndërkombëtare si *Horizon Europe* dhe pjesëmarrje aktive në konferenca dhe seminare akademike.
3. **Rritja/konsolidimi i kompetencës shumëgjuhësore dhe ndërkulturore:** Ofrimi i kurseve të gjuhës dhe programeve të trajnimit në gjuhën shqipe, angleze dhe gjuhë të tjera kryesore evropiane, për të rritur mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Programet akademike me prioritet do të ofrohen në anglisht për të tërhequr studentë ndërkombëtarë.
4. **Zhvillimi i programeve ndërkombëtare të rekrutimit të studentëve:** Përpjekje maksimale për të rekrutuar studentë ndërkombëtarë, duke ndjekur një program studimesh në gjuhën angleze dhe duke zhvilluar strategji marketingu të përshtatura për tregjet globale.
5. **Zgjerimi i pjesëmarrjes në Erasmus+:** Përfshirje në një shkallë më të gjerë e studentëve dhe stafit akademik në programet e shkëmbimit *Erasmus+*, për të përmirësuar mobilitetin ndërkombëtar, për të nxitur bashkëpunimin akademik dhe për të rritur vizibilitetin e universitetit në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).
6. **Mbështetja e bashkëpunimit kërkimor ndërkombëtar:** Nxitja e stafëve akademike të fakulteteve për të bashkëpunuar në projekte kërkimore ndërdisiplinore ndërkombëtare. Krijimi i mekanizmave institucionalë për të mbështetur botimet dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në grantet financiare të kërkimit shkencor ndërkombëtar.
7. **Zhvillimi i programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve akademike:** Trajnimi i stafit akademik dhe përfshirja e tyre në projekte dhe programe ndërkombëtare bazuar në nevojat e tyre.
8. **Nxitja e mjedisit universitar multikulturor:** Promovimi i programeve të shkëmbimit kulturor, duke krijuar mjedis mikpritës për studentët dhe studiuesit ndërkombëtarë. Organizimi veprimtarive, seminareve dhe forumeve ndërkombëtare, të cilat inkurajojnë dialogun dhe bashkëpunimin global.
9. **Sigurimi i përputhshmërisë me standardet akademike globale:** Rishikimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulave, për të siguruar përputhjen me standardet globale, me qëllim përgatitjen me kompetenca konkurruese të studentëve të diplomuar, për tregun global të punës. Pjesëmarrje e rregullt në proceset ndërkombëtare të akreditimit dhe të vlerësimit.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” do të forcojë profilin e tij ndërkombëtar, do të nxisë bashkëpunimet ndërkufitare dhe do të rrisë konkurrencën e tij në arenën globale të Arsimit të Lartë me zbatimin e këtyre masave.



SO4. Përshpejtimi i transformimit digjital

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është i ndërgjegjshëm mbi fuqinë transformuese të teknologjisë digjitale në formësimin e së ardhmes së arsimit. Për të përshpejtuar transformimin e tij digjital, Universiteti është i përkushtuar të nxisë më tej digjitalizimin e proceseve të tij akademike dhe sistemeve administrative. Një fokus kryesor do të jetë zhvillimi i platformave të të nxënimit *online/* në distancë, programeve *e-learning* dhe klasave virtuale që u

ofrojnë studentëve fleksibilitet dhe akses më të madh në arsimin e lartë cilësor. Duke përdorur këto mjete, Universiteti synon të krijojë një mjedis mësimor më gjithëpërfshirës që plotëson nevojat e ndryshme, duke përfshirë profesionistë, studentë ndërkombëtarë dhe individë që punojnë në distancë.

Integrimi i mjeteve më moderne digjitale në procesin e mësimdhënies-nxënies dhe kërkimit shkencor do të përmirësojë përvojën e përgjithshme akademike, duke e bërë këtë proces më ndërveprues dhe më tërheqës. Teknologji të tilla si: simulimet virtuale, mjetet mësimore të drejtuara nga AI dhe analiza e të dhënave, do të përdoren për të pasuruar ofrimin e kurseve dhe për të mundësuar përvoja të personalizuar të të nxënit. Këto mjete të avancuara do të sigurojnë që programet e universitetit të mbeten të rëndësishme në një shoqëri gjithnjë e më digjitale dhe t'i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme për të qenë fuqi punëtore e kualifikuar në të ardhmen.

Për më tepër, transformimi digjital do të shtrihet edhe përtej procesit të mësimdhënies, për të përmirësuar e fuqizuar proceset administrative, efikasitetin dhe transparencën në të gjithë institucionin. Universiteti i Elbasanit, duke përkrahur digjitalizimin, synon të pozicionohet si një institucion modern, vizionar, që jo vetëm përshtatet, por gjithashtu është lider në adresimin e sfidave dhe mundësive të epokës digjitale. Ky transformim do të jetë thelbësor në rritjen e konkurrencës së Universitetit dhe nxitjen e inovacionit brenda komunitetit akademik.

Për të arritur këtë objektiv, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” do të zbatojë këto masa konkrete:

1. **Përmirësimi i infrastrukturës digjitale:** Investimi në teknologjitë më të avancuara dhe infrastrukturën e IT-së, duke përfshirë internetin me shpejtësi të lartë, zgjidhjet e ruajtjes në rene kompjuterike (cloud storage solutions) dhe platformat interaktive të të nxënit, për të mbështetur proceset e mësimit digjital e ato administrative dhe kërkimit shkencor. Vendosja e masave të forta të sigurisë kibernetike për të mbrojtur të dhënat.
2. **Zhvillimi i mësimit online/distancë:** Zgjerimi i ofertave të programeve të studimit në të gjitha ciklet akademike të cilat zhvillohen në mësimdhënien *online* dhe atë të kombinuar. Zhvillimi i programeve të cilësisë së lartë të aksesueshme *online* për të tërhequr studentë jotradicionalë dhe ndërkombëtarë, duke garantuar që mjetet e të mësuarit digjital të integrohen në metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit.
3. **Zhvillimi i aftësive dhe njohurive digjitale:** Ofrimi i programeve të trajnimit, seminareve për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë digjitale të studentëve, fakulteteve dhe stafit akademik. Kjo do të përfshijë aftësi në përdorimin e mjeteve në internet, metodave të kërkimit digjital, softuerin e analizës së të dhënave dhe teknologji të tjera të rëndësishme për detyrat akademike dhe administrative.
4. **Krijimi i një qendre digjitale inovacioni:** Krijimi i një qendre digjitale inovacioni që promovon kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin në teknologjitë digjitale. Kjo qendër mund të jetë një hapësirë bashkëpunuese për studentët, fakultetet dhe partnerët e jashtëm, për të eksperimentuar me teknologjitë në zhvillim, si: IA, ML dhe *blockchain*.
5. **Nxitja e bashkëpunimit digjital dhe i rrjeteve kërkimore:** Promovimi i bashkëpunimit me rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit duke adoptuar instrumente ndërvepruese digjitale, të tilla si: platformat e video-konferencave, softuerët e menaxhimit të projekteve dhe komunitetet e kërkimit virtual. Nxitje në përdorimin e mjeteve digjitale për iniciativat kërkimore ndërdisiplinore dhe ndërkufitare.
6. **Integrimi i mjeteve digjitale në kurrikulën akademike:** Integrimi i kompetencave digjitale në të gjitha programet e studimit. Nxitja e studentëve në përdorimin praktik të

mjeteve të rëndësishme digjitale për fushën e tyre të studimit, duke rritur aftësitë e tyre profesionale për një treg global pune të orientuar drejt teknologjisë.

7. **Nxitja e përdorimit të materialeve burimore mësimore të hapura (OER):** Përshtatja e Materialeve Burimore Mësimore të Hapura (OER) për të rritur aksesin në materiale mësimore cilësore dhe për të nxitur kulturën endarjes së njohurive. Kjo do t'u sigurojë studentëve dhe stafeve akademike të fakulteteve një gamë më të gjerë burimesh dhe mjetesh për procesin e mësimdhënies dhe për të nxënit.
8. **Promovimi i zhvillimit digjital të fakultetit:** Investimi në zhvillimin e vazhdueshëm profesional për stafin akademik të çdo fakulteti, duke rritur aftësitë e tyre të mësimdhënies digjitale dhe duke i familjarizuar ata me mjetet më moderne digjitale dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. Inkurajimi i stafeve akademike të fakulteteve të eksperimentojnë me metoda inovative të mësimdhënies digjitale.
9. **Përdorimi i analizës së të dhënave për vendimmarrje:** Zbatimi platformave analitike të të dhënave për të mbledhur, analizuar dhe përdorur të dhënat e performancës së studentëve, reagimet dhe matjet institucionale. Përdorimi i këtyre të dhënave për të informuar mbi vendimmarrje të ndryshme, për të përmirësuar rezultatet akademike dhe për të rritur efikasitetin operacional.


Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, duke zbatuar këtë grup masash, do të pozicionohet si lider në transformimin digjital në sektorin e arsimit të lartë shqiptar dhe do të nxisë një mjedis akademik më fleksibël, inovativ dhe konkurrues globalisht.

SO5. Mbështetje për zhvillimin e profesionistëve dhe të nxënët gjatë gjithë jetës

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është i angazhuar për të forcuar rolin e tij si një kontribuues i rëndësishëm në zhvillimin e profesionistëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke adresuar nevojat në zhvillim të individëve dhe biznesit në nivel rajonal dhe kombëtar. Universiteti do të zgjerojë gamën e programeve të zhvillimit profesional, mundësitë për edukimin e vazhduar dhe kurset e të nxënit gjatë gjithë jetës. Këto oferta do të kenë në fokus profesionistë që ushtrojnë profesionin, alumni dhe individë që kërkojnë të zhvillojnë më tej kompetencat profesionale, individë që ushtrojnë një profesion përkohësisht ose ata të cilët kërkojnë t'u rezistojnë ndryshimeve të tregut punës.

Universiteti synon t'i pajisë studentët me aftësi praktike dhe njohuri të thelluara të nevojshme për fushat më të preferuara (prioritare), duke zhvilluar programe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet qasjeve ndërdisiplinare dhe multidisiplinare, me synimin që të diplomuarit të përgatiten për të adresuar sfidat komplekse në sektorë të ndryshëm. Këto programe do të formësohen duke u mbështetur në partneritetet me palët e interesuara të biznesit, duke u kujdesur që të kenë ndikim, të jenë relevante dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës në të ardhmen.

Për më tepër, universiteti kërkon të forcojë angazhimin e tij me komunitetin përmes nismave që promovojnë rikualifikimin dhe përmirësimin e aftësive, veçanërisht në fusha të tilla si: kompetencat digjitale, qëndrueshmëria dhe inovacioni. Kjo përpjekje do të rrisë mundësitë e punësimit dhe do të nxisë një kulturë të të nxënit gjatë gjithë jetës, e cila i inkurajon individët vazhdimisht të investojnë në zhvillimin e tyre personal dhe profesional.



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" synon të bëhet një qendër dinamike për rritjen dhe inovacionin arsimor, duke mbështetur zhvillimin e profesionistëve dhe të nxënësve gjatë gjithë jetës, e njëkohësisht duke kontribuar në progresin shoqëror dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë dhe më gjerë.

1. **Krijimi i programeve të edukimit të vazhdueshëm:** Krijimi i një game të gjerë programesh të të nxënësve gjatë gjithë jetës, të cilat përfshijnë kurse afatshkurtra, certifikime dhe mundësi zhvillimi profesional të përshtatura për nevojat e profesionistëve që ushtrojnë profesionin. Këto programe duhet të mbulojnë fushat: risi, aftësitë digjitale, lidhshmërinë, edukimin dhe ekspertizën specifike të biznesit e industrisë, duke bërë të mundur që alumnet dhe profesionistët vendas t'i rezistojnë kohës.
2. **Forcimi i partneriteteve në biznes/industri:** Zhvillimi i partneriteteve strategjike me punëdhënësit e biznesit/industrisë nga fushat më të rëndësishme me qëllim harmonizimin e programeve akademike me nevojat në zhvillim të tregut të punës. Universiteti mund të krijojë intershipe dhe praktika profesionale duke bashkëpunuar me bizneset, e duke u kujdesur që kurrikulat t'u përgjigjen kërkesave të biznesit/ industrisë.
3. **Ofrimi i mënyrave fleksible të të nxënësve:** Zbatimi i mënyrave fleksible të të nxënësve, duke përfshirë mësimin pasdite dhe në fundjavë, programet e studimit *online*/në distancë dhe ato me kohë të pjesshme, për t'u mundësuar të punësuarve dhe individëve të cilët që dëshirojnë të vazhdojnë arsimimin së bashku me përgjegjësitë e tyre profesionale. Ofrimi i këtyre mundësive duhet të garantojë cilësinë drejt kualifikime dhe certifikata të njohura.
4. **Promovimi i vazhdueshëm i shërbimeve të këshillimit të karrierës:** Përmirësimi i shërbimeve të këshillimit të karrierës për t'u ofruar studentëve dhe të diplomuarve mbështetje, praktika, mentorim dhe mundësi për të krijuar network e për të gjetur punë. Ofrimi i këshillimit të karrierës për t'i ndihmuar individët të cilët kërkojnë të ndërrojnë profesion, duke uaplotësuar nevojat për të përmirësuar dhe rifituar kompetenca, me qëllim që të rezistojnë në një treg pune që ndryshon vazhdimisht.
5. **Nxitja e angazhimit të studentëve alumni:** Zhvillimi i rrjeteve aktive alumni të cilët përcjellin në mënyrë të vazhdueshme njohuri e përvojë dhe ndikojnë në zhvillimin profesional. Të diplomuarve t'u krijohet akses në burimet universitare, duke përfshirë shërbimet e karrierës, seminarët dhe kurset e edukimit të vazhduar, për t'u krijuar mundësi që të fitojnë kompetencat e nevojshme në fushat e ekspertizës që mbulojnë.
6. **Nxitja e një kulture për të nxënësve gjatë gjithë jetës:** Integrimi i kulturës së të nxënësve gjatë gjithë jetës në praktikën dhe moralin e universitetit. Promovimi i edukimit e vazhduar në të gjitha fazat e jetës dhe të karrierës, duke organizuar seminare, *workshop*-e dhe veprimtari që theksojnë rëndësinë e zhvillimit të kompetencave dhe rikualifikimit të tyre për të realizuar me sukses një karrierë afatgjatë.
7. **Përdorimi i mjeteve digjitale për zhvillimin e profesionistëve:** Integrimi i platformave të mësimdhënies *online*/distancë, *webinare*-ve dhe pajisjeve e mjeteve digjitale të cilat u lejojnë individëve të përdorin materiale burimore mësimore me cilësi të lartë për të zhvilluar kompetencat. Ofrimi i aksesit në kurse e programe të cilat përdorin mjetet më moderne digjitale dhe tendencat e teknologjisë.
8. **Certifikimi i programeve të përbashkëta me biznesin/industrinë:** Programe të përbashkëta certifikimi të universitetit me biznesin/industrinë dhe organizma të tjerë profesionalë, për të krijuar mundësi që të diplomuarit dhe profesionistët të fitojnë kredenciale të njohura në tregun e punës. Këto certifikata duhet të adresojnë kërkesat aktuale dhe prirjet ardhshme të biznesit/ industrisë.
9. **Fokusimi në aftësitë e buta dhe atyre të punësimit:** Zhvillimi i programeve të fuqizimit aftësive të punësimit, përveç aftësive teknike, fokusohen tek aftësitë e buta si

komunikimi, zgjidhja e problemeve, puna në grup dhe lidhshpi. Këto janë aftësi themelore për t'urritur në karrierë dhe për të qenë i përshtatshëm për tregun e punës.

10. **Mbështetja e sipërmarrjes dhe inovacionit:** Promovimi i sipërmarrjes si një nga format më të sigurta e të qëndrueshme për t'urritur në karrierë, duke ofruar burime, mentorim dhe trajnim për zhvillimin e biznesit, menaxhimit financiar dhe inovacionin. Krijimi i qendrave të inovacionit ose i laboratorëve brenda universitetit për të inkurajuar studentët dhe profesionistët të hapin biznese dhe të kontribuojnë në ekonominë lokale.

Me zbatimin e këtyre masave, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” jo vetëm do të mbështesë zhvillimin profesional të studentëve të tij, por do të kontribuojë edhe në nxitjen dhe rritjen e vazhdueshme të profesionistëve shqiptarë për të përballuar sfidat e një tregu modern të punës.

SO6. Investimi në zhvillimin e infrastrukturës dhe kampusit

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është i ndërgjegjshëm se infrastruktura moderne është jetike për të nxitur një mjedis të ekselencës akademike, të inovacionit dhe të bashkëpunimit. Për këtë qëllim, Universiteti synon të zbatojë një plan gjithëpërfshirës për modernizimin dhe zgjerimin e objekteve të kampusit. Ai përfshin përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, zgjerimin e laboratorëve kërkimorë dhe përmirësimin e shërbimeve për studentët, për t'usiguruar një mjedis mësimor të favorshëm dhe gjithëpërfshirës. Hapësirat që inkurajojnë kreativitetin, inovacionin dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor do të kenë përparësi, duke u mundësuar studentëve, stafëve akademike të fakulteteve dhe studiuesve të zhvillohen e të përparojnë në një mjedis akademikilësor në të gjithë infrastrukturën e tij.

Fokusi kryesor i këtij objekti është investimi në pajisje digjitale dhe mjete moderne për kërkimin shkencor të cilat janë në koherencë me standardet ndërkombëtare. Universiteti po punon për të përmirësuar sistemet e bibliotekave të tij, duke integruar mjetet digjitale më të avancuara, me qëllim që studentët dhe pedagogët të kenë akses në literaturën shkencore dhe bazat e të dhënave kërkimore më të përditësuara. Procesi i digjitalizimit të infrastrukturës së universitetit do të ndikojë në përmirësimin e të gjitha veprimtarive edukative, duke e pozicionuar si lider në përdorimin e teknologjisë në funksion të modernizimit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Gjithashtu investimi strategjik në modernizimin e mjeteve të kërkimit shkencor do t'i mundësojë Universitetit të ndjekë projekte të avancuara në fusha të rëndësishme si zhvillimi i qëndrueshëm, transformimi digjital dhe shkencat e aplikuara. Duke krijuar laboratorë të pajisur mirë dhe mjedise pune bashkëpunuese, Universiteti synon të tërheqë studiues profesionistë dhe të nxisë inovacionin i cili ka impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik.

Nëpërmjet këtyre përpjekjeve, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” kërkon të pozicionohet si një institucion akademik model, duke ofruar një mjedis me standarde ndërkombëtare që plotëson nevojat e studentëve, stafit dhe komunitetit më të gjerë. Këto investime do t'i krijojnë mundësinë që Universiteti të jetë të institucion avangard i Arsimit të Lartë dhe të kërkimit shkencor në Shqipëri dhe rajon.



SO7. Përmirësimi i vizibilitetit global dhe renditjes ndërkombëtare

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” synon të jetë i vlerësuar në reputacionin e tij brenda dhe jashtë vendit dhe të mbajë pozicion ambicioz në rankimin ndërkombëtar. Baza e kësaj përpjekjeje qëndron në zgjerimin e programeve pasuniversitare dhe të doktoratës, veçanërisht në fushat ndërdisiplinare dhe multidisiplinare. Këto programe do të adresojnë sfidat globale në zhvillim, duke nxitur zgjidhje inovative që kontribuojnë në zhvillimin shoqëror. Duke integruar disiplina të ndryshme akademike, Universiteti synon të prodhojë të diplomuar dhe studiues me formim të thellë akademik ndërdisiplinar e gjithëpërfshirës të çështjeve komplekse globale, duke i bërë ata shumë konkurrues në tregun ndërkombëtar të punës.

Për të çuar më tej këtë objektiv, Universiteti do t'i japë përparësi nxitjes së një kulture akademike të orientuar drejt kërkimit shkencor që është në koherencë me standardet ndërkombëtare. Kjo përfshin mbështetjen e stafeve akademike të fakulteteve dhe studentëve për të marrë pjesë aktive në konferenca ndërkombëtare, për të publikuar në revista me indeksim të lartë dhe për të bashkëpunuar me institucione me reputacion ndërkombëtar. Duke promovuar cilësinë në kërkimin shkencor dhe duke garantuar që rezultatet akademike të përmbushin standardet ndërkombëtare, Universiteti do të forcojë kontributet e tij në komunitetin e institucioneve ndërkombëtare akademike të arsimit të lartë dhe do të rrisë vizibilitetin e tij në këtë kontekst.

Për më tepër, Universiteti do të zhvillojë iniciativa strategjike për të harmonizuar programet e studimit dhe veprimtaritë kërkimore me standardet ndërkombëtare të akreditimit. Këto përpjekje do të mundësojnë që diplomat të njihen e të vlerësohen nga institucione dhe kompani prestigjioze globale. Për më tepër, partneritetet e synuara me universitetet kryesore, qendrat kërkimore dhe bizneset do të hapin rrugë për shkëmbim njohurish, projekte të përbashkëta dhe praktika inovative që forcojnë renditjen të Universitetit rankimet ndërkombëtare.

Përmes përpjekjeve të mirorientuara Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” synon të sigurojë pozicionin e tij si një institucion i njohur globalisht për cilësi akademike, ndikim e kërkimit shkencor dhe përkushtimin e tij në adresimin e sfidave aktuale e imediate të botës moderne.

SO8. Etika në kërkimin shkencor dhe sjelljen

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është i angazhuar të ruajë të forcojë dhe të promovojë në mënyrë rigorozetikë në kërkimin shkencor dhe sjelljen. Për këtë arsye ka hartuar Strategjinë e Etikës në Kërkimin Shkencor dhe Sjelljen. Kjo strategji nxit ndershmërinë akademike, integritetin shkencor dhe respektin për të drejtat themelore të njeriut. Bazuar normativën ligjore në fuqi si dhe në standardet evropiane të kërkimit shkencor, ajo thekson parimet e Open Science dhe dominimin e njeriut mbi inteligjencën artificiale. Gjithashtu promovon transparencën, lirinë akademike dhe ndarjen e hapur të njohurive për të forcuar inovacionin dhe zhvillimin shkencor.

Për të arritur këtë objektiv, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” do të zbatojë këto masa konkrete:

1. Etika në Kërkimin Shkencor dhe Open Science:

- Zbatimi i normave të etikës në të gjitha fazat e kërkimit, duke shmangur manipulimin e të dhënave dhe konfliktet e interesit;

- Inkurajimi i qasjes së hapur ndaj publikimeve shkencore dhe promovimi i riprodhueshmërisë së rezultateve;
 - Respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe mbrojtja e të dhënave personale sipas rregullave etike dhe ligjore;
 - Përfshirja e mekanizmave etikë në vlerësimin e projekteve kërkimore për të siguruar ndikimin pozitiv shoqëror.
- 2. Sjellja e personelit akademik dhe studentëve:**
- Promovimi dhe mbrojtja e pavarësisë akademikenga profesorët dhe studiuesit duke krijuar një kulturë etike dhe transparence në publikimet e tyre;
 - Respektimi i rregullave të ndershmërisë akademike ngastudentët e të gjitha niveleve, përfshirë doktorantët, duke shmangur çdo formë mashtrimi apo plagjiature;
 - Zhvillimi i mekanizmave të mentorimit për studentët dhe kërkuesit e rinj për të rritur ndërgjegjësimin mbi etikën akademike.
- 3. Sjellja e personelit jo-akademik:**
- Veprimi me integritet, transparencë dhe përgjegjësi e stafit administrativ në menaxhimin e shërbimeve universitare;
 - Promovimi i një kulture etike në komunikim dhe vendimmarrje për të përmirësuar efikasitetin dhe ndershmërinë institucionale.
- 4. Predominimi i veprimit njerëzor/human mbi Inteligjencën Artificiale:**
- Ruajtja e kontrollit njerëzor mbi vendimmarrjen akademike dhe kërkimore, duke shmangur varësinë e tepruar nga Inteligjenca Artificiale;
 - Sigurimi i përdorimit etik të AI, duke parandaluar diskriminimin dhe keqpërdorimin e të dhënave shkencore.
- 5. Mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit:**
- Monitorimi i zbatimit të parimeve etike nga Këshilli i Etikës për të identifikuar dhe adresuar rastet e të shkeljeve të mundshme;
 - Organizimi i trajnimeve për rritjen e ndërgjegjësisë mbi standardet etike në mjedisin akademik;
 - Hartimi i një sistemi raportimi dhe verifikimi për shkeljet e etikës, duke garantuar një kulturë të përgjegjësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Miraturar me vendim të Senatit Akademik Nr. 28 datë 10.03.2025 dhe Vendim të Bordit të

Administrimit Nr.18 datë 20.03.2025

